



RAPORT KOMBETAR

SHQIPËRIA

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



Bashkëpunimi për Mbrojtjen e Mjedisit nga Autoritetet
Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë (COPEIJ)

Tetor 2023

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
PREZANTIM I RESIJ	4
PREZANTIM I COPEIJ	5
Metodologjia.....	6
KUADRI JURIDIK KOMBËTAR E NDËRKOMBËTAR	
Konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria	7
Kuadri juridik kombëtar për mbrojtjen e mjedisit.....	8
Situata e transpozimit të instrumenteve juridike europiane për mbrojtjen e ambientit.....	9
JURISPRUDENCA	
Jurisprudenca e GJEDNJ.....	10
Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.....	11
Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë të Republikës.....	12
Jurisprudenca e Gjykatës Administrative.....	12
SITUATA: KUADRI INSTITUCIONAL	
Paraqitje e autoriteteve administrative kombëtare.....	13
Autoritete të tjera dhe institucione akademike.....	15
Autoritete Gjyqësore të Specializuara.....	16
Organizata të Shoqërisë Civile.....	17
Të dhëna statistikore	
Të dhëna statistikore mbi shkeljet penale.....	18
Të dhëna statistikore mbi proceset administrative.....	20
SPECIALIZIMI I AUTORITEVE GJYQËSORE DHE ORGANEVE TË TJERA LIGJZBATUESE	20
BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI I VEPRIMTARIVE TË AUTORITETEVE QË OPEROJNË NË MBROJTJE TË MJEDISIT	21
BASHKËPUNIMI GJYQËSOR.....	22
VËSHTIRËSITË DHE PRAKTIKAT E MIRA	
Agjenda e gjelbër për Ballkanin Perëndimor.....	23
Procesi i negociatave të antarësimit në BE.....	24
REKOMANDIME KOMBËTARE	
Rekomandime të natyrës legislative.....	25
Rekomandime administrative.....	26
REKOMANDIME NDËRKOMBËTARE.....	27
ANEKSE	
Shkeljet penale në fushën e mjedisit të parashikuara në Kodin Penal shqiptar	28
Lista e personave të kontaktuar.....	30
Konsultime të faqeve të internetit të institucioneve.....	30
Identifikimi i OJF-ve të specializuara.....	31

HYRJJE

Sfidat e mjedisit janë ato që kanë rritur presionin mbi qeveritë për të gjetur mënyra për të zvogëluar dëmtimin e mjedisit, duke minimizuar dëmin në rritjen ekonomike. Qeveritë kanë një gamë të mjeteve në dispozicion të tyre, duke përfshirë sistemin rregullator, iniciativat e suksesshme në politikat mjedisore, programet informative, subvencionet, taksat mjedisore etj.

Ndërsa legjislacioni mjedisor përparon, kostot e pajtueshmërisë rriten. Me qëllim uljen e kostove, individë apo grupe kriminale përfitojnë nga boshllëqet ligjore, kontrolli i dobët apo kapacitetet e ulëta inspektuese dhe hetuese. Prandaj, legjislacioni efektiv, rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve përgjatë zinxhirit të kontrollit, inspektimit dhe hetimit është i domosdoshëm në luftën kundër krimeve mjedisore.

Krimi mjedisor shpesh përkufizohet si një term kolektiv që përfshin aktivitete të paligjshme që dëmtojnë mjedisin dhe përfitojnë grupe ose individë nga shfrytëzimi ose shkatërrimi, tregtia dhe grabitja e burimeve natyrore, të cilat përfshijnë krime të rënda dhe krime të organizuara ndërkombëtare.

Veprat penale kundër mjedisit mund të përfshijnë ndër të tjera, shfrytëzimin dhe trafikimin e paligjshëm të burimeve natyrore, duke përfshirë florën dhe faunën, si dhe ndotjen e tokës dhe ujit nga hedhja e paligjshme e mbetjeve.

Disa krime mjedisore bien gjithashtu në kategorinë e krimit të organizuar dhe ndërkombëtar, pasi grupet dhe rrjetet kriminale po përfshihen gjithnjë e më shumë në këtë biznes fitimprurës në rritje.

Krimet mjedisore jo vetëm që ndikojnë rëndë cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës, duke kërcënuar mbijetesën e specieve dhe duke shkaktuar fatkeqësi të pakontrollueshme, por ato paraqesin gjithashtu kërcënime për sigurinë dhe për një numër të madh njerëzish me ndikime të konsiderueshme negative në zhvillimin ekonomik dhe minojnë sundimin e ligjit.

Të perceptuara shpesh si krime "pa viktime" dhe të rastësishme, krimet mjedisore shpesh renditen poshtë në listën e prioriteteve të zbatimit të ligjit dhe zakonisht ndëshkohen me sanksione të ulëta, si rezultat i përkufizimeve të paqarta dhe keqinterpretimit të koncepteve. Në këtë kontekst, ky raport bazë mundëson një analizë të detajuar të kuadrit ligjor mjedisor shqiptar, të kapaciteteve institucionale, duke përfshirë si aspektin e burimeve njerëzore dhe financiare, ashtu edhe aspekte të veprimtarisë së tyre.

Prezantim i RESIJ

RESIJ, Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë është krijuar në Paris, në mars 2017, si një iniciativë e Francës, në prani të përfaqësuesve të Bashkimit European e Komisionit European për efikasitetin e drejtësisë të Këshillit të Evropës (CEPEJ) dhe përfaqësuesve nga Belgjika, Republika Çeke, Franca, Italia, Lituania, Mali i Zi, Holanda, Polonia, Portugalia, Roumania, Serbia, Sllovenia, Spanja, Britania e Madhe.

Synimi ishte gjetja e modaliteteve, sesi shërbimet kombëtare të inspektimit të drejtësisë të mund të kontribuonin në mënyrë më aktive, në zhvillimin uniform të zonës gjyqësore evropiane të sanksionuar, që nga Traktati i Amsterdemit tek Traktati i Romës.

Pavarësisht dallimeve institucionale dhe funksionale, si lidhja e shërbimeve të inspektimit me ministrinë e drejtësisë a këshillin gjyqësor, pjesëmarrësit konvergjuan tek e përbashkëta themelore, që bashkon sistemet e ndryshme të inspektimit, sic është pavarësia e nevojshme në ushtrimin e misioneve të tyre.

Në dritën e këtij vëzhgimi, pjesëmarrësit diskutuan me përfaqësues të Komisionit European dhe CEPEJ, mbi rolin që shërbimet kombëtare të inspektimit të grupuar në një Rrjet, mund të luajnë në vlerësimin e efektivitetit dhe cilësisë së drejtësisë në nivel evropian dhe hapjen e perspektivave për bashkëpunim dhe trajnime të përbashkëta në shkallë evropiane. Në takimin themelues të Rrjetit u propozua gjithashtu zhvillimi i programeve të përbashkëta të trajnimit dhe shkëmbimit për inspektorët e drejtësisë midis vendeve, angazhimi i shërbimeve të inspektimit për të kontribuar në vlerësimin e efektivitetit dhe cilësisë së drejtësisë në nivel evropian dhe në veçanti të instrumenteve evropiane, asistencës juridike civile dhe penale.

Në dhjetor 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i Shqipërisë (ILD) u pranua me statusin e vendit vëzhgues në gjirin e këtij Rrjeti, që përbëhej nga Belgjika, Bullgaria, Franca, Italia, Spanja, Portugalia dhe Rumania.

Prej 19 tetorit 2023, anëtarët e Rrjetit vendosën të pranonin Inspektorin e Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë, si anëtar me të drejta të plota. Që prej dhjetorit 2021, ILD është angazhuar aktivisht në cdo aktivitet të RESIJ, si në vendet anëtare ashtu edhe jashtë (Konferenca rajonale Sud-Medij, Mbështetje rajonale për forcimin e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracinë në Mesdheun jugor, mbështetur nga COPEIJ), e së fundmi edhe në projektin COPEIJ, me bazë vullnetare. Raporti do dorëzohet sipas kërkesës së projektit, në gjuhën frënge.

Prezantim i misionit evropian COPEIJ

Në dhjetor 2019, Komisioni Evropian propozoi një pakt të gjelbër për Evropën dhe Bashkimin Evropian (BE) dhe qytetarët e tyre, duke pohuar se “ndryshimi klimatik dhe degradimi i biodiversitetit përbën një kërcënim ekzistencial për Evropën dhe pjesën tjetër të botës” Komisioni theksoi nevojën për të siguruar, që politikat dhe legjislacioni të zbatohen në mënyrë efektive dhe të prodhojnë rezultate konkrete. Kështu, ai u jep një rol të veçantë dhe thelbësor sistemeve gjyqësore duke propozuar “përmirësimin e aksesit në kontrollin administrativ dhe gjyqësor në nivel të BE-së për qytetarët dhe OJQ-të që kanë dyshime për ligjshmërinë e vendimeve që kanë ndikim në mjedis.

Referuar strategjisë së biodiversitetit 2030, mes angazhimeve të marra si lufta kundër tregtisë së paligjshme të kafshëve të egra, forcimi i lidhjeve midis mbrojtjes së biodiversitetit dhe të drejtave të njeriut, barazia gjinore, shëndetësia, arsimiti, ndjeshmëria ndaj konflikteve, bazuar në të drejtat. qasja, zotërimi i tokës dhe roli i popujve indigjenë dhe komuniteteve lokale, shprehet angazhimi se "Komisioni do të përpiqet, në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare dhe rrjetet evropiane të agjencive mjedisore, inspektorëve, auditorëve, shërbimeve policore, prokurorëve dhe magistratëve, për të përmirësuar sigurimin e pajtueshmërisë. E më tej përcaktimin e termit “dëm mjedisor”, përkufizimi i të cilit kushtëzon efektivitetin e parandalimit dhe riparimit të dëmeve mjedisore.

Në të gjitha vendet, mosmarrëveshjet mjedisore deri më tani janë trajtuar pak ose aspak nga gjykatat, ku përgjigja ndaj këtyre shkeljeve është një çështje e politikës publike që i është besuar kryesisht autoriteteve publike evropiane, kombëtare ose lokale. Këto politika publike, shpesh sektoriale, janë shoqëruar mjaft sistematikisht me futjen e një komponenti kriminal, duke përfshirë përcaktimin e inkriminimeve specifike dhe dënimeve shumë të ndryshme të shkaktuara, por zbatimi efektiv i të cilave është mjaft i dobët. Hendeku midis emergjencës mjedisore, pritjeve të qytetarëve dhe dobësisë së reagimit gjyqësor duhet të kapërcehet.

Projekti COPEIJ i përgjigjet një nevoje sistematike, qytetare, policore, gjyqësore dhe administrative për thjeshtimin dhe përcaktimin e inkriminimeve mjedisore, rritjen e sanksioneve, trajnimin e specializuar të aktorëve, forcimin e zinxhirit represiv.

Projekti COPEIJ do të paraqesë rekomandime dhe do të zhvillojë mjete për të reduktuar në mënyrë operative hendekun midis nevojës për drejtësi penale efektive mjedisore dhe realitetit aktual.

COPEIJ ka një koordinator (Expertise France) dhe 4 shërbime kombëtare, autoritetet kombëtare të inspektimit të drejtësisë të shteteve anëtare përfituese (Francë, Itali, Portugali, Rumani), anëtarë themelues të Rrjetit Evropian të Shërbimeve Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ)). Franca si kryesuese e RESIJ në momentin e nisjes së projektit, do të koordinojë ekipin evropian të inspektimit.

Shërbime të tjera inspektuese, anëtarë të RESIJ, mund të ftohen të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në këtë punë në baza vullnetare. Ftesë i është dërguar ILD-së, që e ka pranuar dhe i është bashkuar këtij projekti në bazë vullnetare, duke u bërë pjesë në aktivitetet studimore të tij, me synim përcjelljen e panoramës së Shqipërisë, përmes prodhimit të një raporti kombëtar.

Metodologjia

Ky raport ka si synim të paraqesë një analizë të detajuar të kuadrit ligjor mjedisor shqiptar dhe të kapaciteteve institucionale të vendit. Gjithashtu nëpërmjet këtij raporti synohet paraqitja e normave ndërkombëtare, të cilat janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm, legjislacionit të brendshëm në fushën e krimeve mjedisore dhe mbrojtjes së mjedisit, rolin e institucioneve të përfshira përgjatë gjithë zinxhirit të përputhshmërisë, forcimit ligjor dhe hetimin e ndëshkimit të krimeve mjedisore në vend, praktikën më të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, statistika mbi kriminalizimin e krimeve mjedisore përgjatë harkut kohor 2019-2022, paraqitjen e problematikave dhe rekomandimeve për përmirësim të situatës kombëtare.

Metodologjia e përdorur ka konsistuar kryesisht në kërkimin dokumentar dhe marrjen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve dhe statistikave nga gjykatat dhe zyrat e prokurorive. Kërkimi dokumentar ka konsistuar në analizën e ligjeve, akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera mbi zbatimin e legjislacionit në fuqi për krimin mjedisor në Shqipëri. Gjetjet nga kërkimi dokumentar, më pas u verifikuan dhe u plotësuan nëpërmjet informacionit dhe të dhënave statistikore në vëna në dispozicion.

Gjetjet dhe propozimet e këtij raporti synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e bashkëpunimit mes institucioneve e agjensive të ndryshme të specializuara për monitorimin, e zbatimin e rregulloreve e ligjeve për mbrojtjen mjedisore, e ndëshkimit e veprave penale mjedisore, përmes bashkëpunimit edhe me partnerë ndërkufitarë e më gjerë. Në nivel kombëtar, nxitja e koordinimit edhe me aktorë jo qeveritarë të specializuar si OJF-të, shoqata dhe profesionistë të fushës së mjedisit , si mënyrë për të kontribuar në mënyrë sa më efikase në përmirësimin e aksesit për të kontribuar në përmirësimin e aksesit në kontrollin administrativ dhe gjyqësor të drejtësisë mjedisore.

KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR DHE VENDAS

Konventat ndërkombëtare në fushën e krimit mjedisor të ratifikuara apo në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar

Shteti shqiptar, është bërë palë e mjaft konventave në fushën e mjedisit, duke i nënshkruar e duke marrë përsipër angazhimin për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto instrumente ndërkombëtare ku ndër më kryesoret mund të përmendim:

Konventën e Bazelit. Republika e Shqipërisë, aderoi në vitin 1999 në Konventën “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre” nëpërmjet ligjit nr.8216, datë 13.5.1997 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit”.

Konventën e Stokholmit. Republika e Shqipërisë aderoi vitin 2004 nëpërmjet ligjit nr.9263, datë 29.07.2004, në këtë Konventë që synon mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit nga efektet e ndotësve të qëndrueshëm organikë. Aktualisht është miratuar një legjislacion kuadër për zbatimin e angazhimeve ndërkombëtare për kimikatet. Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” përcakton kuadrin ligjor për zbatimin e konventave ndërkombëtare në këtë fushë. Me synim përafrimin e plotë të kuadrit ligjor kombëtar me legjislacionin e BE-së, është miratuar legjislacioni shtesë mbi: regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve, eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.

Konventën e Roterdamit. Republika e Shqipërisë aderoi në Konventën e Roterdamit në vitin 2010 nëpërmjet ligjit nr. 10277, datë 13.05.2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit “Për procedurën e Pëlqimit të Informuar Paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”. Shqipëria i ka paraqitur Konventës procedurat për importimin e 47 kimikateve të listuara në Aneksin III të Konventës dhe që i nënshtrohen Procedurës së Pëlqimit të Informuar Paraprak.

Konventën e Vjenës “Për mbrojtjen e shtresës së ozonit”. Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Konventë në vitin 1999 dhe gjithashtu ka bërë aderuar në të gjitha amendamentet.

Konventa mbi Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale, e hartuar nga Këshilli i Evropës, u nënshkrua në Strasburg më 4 Nëntor 1998. Kjo Konventë synon kriminalizimin e të gjitha veprimeve të paligjshme të drejtuara kundër mjedisit dhe që rrezikonin si rrjedhim edhe shëndetin njerëzor. Konventa ka gjithashtu për qëllim që të harmonizojë legjislacione të brëndshme penale të shteteve duke parashikuar elemente të rinj të veprave penale të drejtuar ndaj mjedisit, sanksionet përkatëse, përgjegjësinë penale dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në luftën kundër krimit mjedisor.

Konventën e Aarhusit “Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimarrje dhe të drejtën për tu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin”,

ratifikuar nga shteti shqiptar në vitin 2000. Konventa është një dokument juridik ndërkombëtar që vendos një sërë të drejtash për publikun dhe detyrime për autoritetet shtetërore. Konventa përmban tre shtylla themelore:

- E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor;
- E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
- E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit

Kuadri ligjor kombëtar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 56 të saj se:

“Kushdo ka të drejtë të informohet për gjëndjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij.”

Më tej në kapitullin e objektivave sociale në nenin 59 paragrafi 1 pika d) dhe dh) Kushtetuta përsëri përmend fjalën “mjedis” për një rregullim më të detajuar dhe më specifik në kuadër të këtyre objektivave duke parashikuar që:

“1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:..d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”.

Nga rregullimet kushtetuese të përmendura më sipër buron e drejta e çdokujt për t'u informuar mbi gjëndjen e mjedisit dhe mbi masat që merren nga autoritetet shtetërore për mbrojtjen e tij. Përballë kësaj të drejte qëndron qartësisht detyrimi kushtetues që i atribuohet shtetit për të marrë të gjitha masat e domosdoshme për të garantuar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm në dobi të të gjithë shoqërisë.

Detyrimet e mësipërme kushtetuese detajohen edhe në akte të rëndësishme ligjore ku përfshihet dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Legjislacioni ynë penal garanton mbrojtje juridiko-penale ndaj mjedisit, duke marrë përsipër të mbrojtje në mënyrë të drejtëpërdrejtë marrëdhëniet juridike të vendosura në Kushtetutë, apo në ligje të tjera që lidhen me mjedisin.

Normat penale sigurojnë mbrojtje të mjedisit nga të gjitha veprimet apo mosveprimet shoqërisht të rrezikshme, si të tilla të kundraligjshme të kryera me faj dhe që shoqërohen me ardhjen e pasojave të rrezikshme. Në kuadër të mbrojtjes juridiko-penale parashikohen dënime konkrete penale të cilat zbatohen nga gjykata ndaj autorëve të këtyre veprave penale. Jo vetëm individët por edhe personat juridikë përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre nga funksionarët e tyre. Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë janë parashikuar figura konkrete të veprave penale kundër mjedisit si edhe dënimet përkatëse për autorët e këtyre veprave penale. Veprat penale kundër mjedisit së bashku me ndryshimet ligjore janë parashikuar në Kreun IV të Kodit Penal aktual, si më poshtë:

Përkatësisht në kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”, fillimisht përfshiheshin nenet 201-

207, që përfshinin sanksione për ndotjen e ajrit, transportimin e mbeturinave toksike, ndotjen e ujërave, peshkimin e ndaluar, prerja e paligjshme të pyjeve, prerjen e drurëve dekorativë dhe frutorë, shkeljen e karantinës së bimëve dhe kafshëve. Fillimisht shkelësit e këtyre veprave penale në varësi të shkeljes dënoheshin sipas rastit me gjobë ose edhe me burgim deri në pesëmbëdhjetë vite burg.

Me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, janë shtuar në kreun IV, “Vepra penale kundër mjedisit”, dy vepra të reja penale, në nenet 206/a “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”, dhe 206/b “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”, të cilët parashikojnë se sanksionet për këto krime arrijnë përsëri deri në burgime me pesëmbëdhjetë vite.

Me ligjin nr. 144/2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, u amenduan dhe dy nenet e kreut IV, përkatësisht nenet 206/a dhe 206/b duke hequr dënimin me gjobë dhe ashpërsuar dënimin me burgim.

Ndryshimet e fundit ligjore, të miratuara me ligjin nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, kanë shtuar numrin e veprave penale kundër mjedisit, dhe kanë amenduar disa prej veprave penale ekzistuese. Me anë të këtyre ndryshimeve janë përmirësuar neni 201 “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës”, neni 202 “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër” dhe neni 203 “Substancat ozonholluese”, ndërkohë që janë shtuar pas nenit 201, nenet: 201/a “Menaxhimi i mbetjeve”, 201/b “Transportimi i mbetjeve”, 201/c “Aktivitetet e rrezikshme” dhe 201/ç “Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”; pas nenit 202: nenet 202/a “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër” dhe 202/b “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”; pas nenit 207: nenet 207/a “Braktisja e kafshës të shoqërimit”, 207/b “Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit”, 207/c “Keqtrajtimi i kafshës” dhe 207/ç “Ndeshjet ndërmjet kafshëve”.

Situata e transpozimit të instrumenteve ligjore evropiane për mbrojtjen e mjedisit

Ndryshimet ligjore të miratuara në Kodin Penal në vitin 2019 kanë synuar jo vetëm ashpërsimin e dënimeve për krimet mjedisore, si një instrument i rritjes së ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit tek të gjithë aktorët që veprojnë dhe që kanë potencial për ta rrezikuar atë përmes aktiviteteve të tyre dhe për ndëshkimin e veprimtarisë së kundërligjshme, por edhe transpozimin e pjesshëm të Direktivës 2008/99/EC “Për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal”.

Më 15 dhjetor 2021, Komisioni Evropian miratoi një propozim për një Direktivë të re për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, për të zëvendësuar Direktivën e vitit 2008. Nëpërmjet këtij propozimi synohet një përkufizim më i qartë i veprave penale në fushën e mjedisit, shtimi i kategorive të reja të shkeljeve që klasifikohen si krime mjedisore; forcimi i zinxhirit të zbatimit përmes dispozitave për trajnimin, mjetet hetimore, bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve, mbledhjen e të dhënave dhe strategjitë kombëtare.

Pas miratimit të saj nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli mund të lind nevoja e rishikimit të Kodit Penal lidhur me kategorizimin e veprimeve dhe mosveprimeve që përbëjnë vepra penale në fushën e mjedisit, dënimet përkatëse ose amendimin e veprave penale ekzistuese duke i harmonizuar ato me risitë që mund të sjellë Direktiva.

Aktualisht Ministria e Drejtësisë, që prej vitit 2020 është në fazën e ndërmarrjes së një reforme të re në fushën e drejtësisë penale, nëpërmjet rishikimit tërësor të Kodit Penal, nismë që pritet të sjellë një standardizim dhe qëndrueshmëri të drejtësisë penale. Duke mbajtur në konsideratë fazën të cilën ndodhet vendi ynë, si vend kandidat për anëtarësimin në BE, transpozimi i plotë i direktivave në legjislacionin e brendshëm ku përfshihet edhe direktiva për mbrojtjen e mjedisit në procesin penal përbën një prioritet në fushën e hartimit të legjislacionit.

JURISPRUDENCA

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore (GJEDNJ)

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut në kuadrin e rregullimeve ligjore që i bën këtyre të drejtave dhe lirive, nuk përmban në mënyrë specifike të përcaktuar apo të shprehur në ndonjë nen të saj ndonjë rregullim lidhur me mjedisin. Duke argumentuar se mjedisi përfshihet në “interesin e përgjithshëm të shoqërisë”, GJEDNJ ka marrë parasysh balancën e drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Kështu pavarësisht “mungesës së një rregullimi të përcaktuar shprehimisht për mjedisin, GJEDNJ i ka dhënë zgjidhje çështjeve duke zbatuar nenet përkatëse të Konventës, që përfshijnë rregullime të përgjithshme lidhur me mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave themelore duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtën për të pasur një mjedis të pastër e cila lidhet drejtëpërdrejtë me të drejtën për të gëzuar jetën private, pronën, familjen etj. Raste të ndryshme të trajtuara nga Gjykata e Strasburgut ofrojnë perspektiva premtuese për garantimin e të drejtave mjedisore të njeriut në mënyrë konkrete dhe efektive. Nëpërmjet shembujve të dhënë më poshtë, vëmë re vëmendjen e gjyqtarit evropian për të marrë parasysh realitetin e situatave konkrete, të cilat gjithnjë e më shpesh lindin pengesë për zbatimin mekanik të rregullave të përgjithshme, nëpërmjet vendimeve të drejtësisë mbrojtëse të mjedisit

Gjykimi *Moreno Gomez kundër Spanjës*. Kërkesja pretendonte shkelje të nenit 8 të KEDNJ. Në këtë rast Gjykata theksoi se e drejta e kërkuar ishte çënuar seriozisht ngaqë autoritetet shtetërore nuk kishin marrë masa për shqetësimet që mund të sillnin zhurmat e klubeve të natës. Duke mbajtur parasysh se zhurma e shkaktuar nga klubet e natës kishte qenë tej niveleve të lejuara dhe kishte vazhduar të sillte shqetësime prej vitesh, Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 8 të KEDNJ.

Një tjetër rast i ngjashëm, **çështja *Cuenca Zarzoso kundër Spanjës***, ku kërkesja vuante nga zhurma e pandërprerë e natës, që vinte nga klubet e natës të ngritura pranë shtëpisë së saj dhe bënte përgjegjës autoritetet spanjolle. Gjykata konfirmoi ekzistencën e një “të drejte si duhet për të fjetur, të drejtën për të shijuar shtëpinë me dritare të hapura”, duke konstatuar kështu se kishte pasur shkelje të nenit 8 të KEDNJ.

Gjykimi *DEÉS kundër Hungarisë*. Kërkesi ankohej nga zhurmat e shumta, dridhje si edhe ndotje si pasojë e trafikut të parregulluar dhe të rënduar në rrugën pranë shtëpisë së tij. GJEDNJ argumentoi se pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve vendore për të reduktuar trafikun e rënduar kërkesi kishte jetuar prej një kohe shumë të gjatë i ekspozuar ndaj zhurmave dhe ndotjeve për shkak të trafikut. Sipas GJEDNJ është çënuar e drejta e tij për të gëzuar jetën private dhe familjare e kështu që ishte shkelur neni 8 i Konventës.

Gjykimi *Dubetska dhe të tjerë kundër Ukrainës*. Mbështetur në nenit 8 të Konventës kërkesit ankoheshin për probleme shëndetësore, dëmtime të shtëpive të tyre dhe mjedisit si pasojë e një

miniere qymyri dhe një fabrike që ushtronte aktivitet afër shtëpive të tyre. Për pasojë nuk mund të gëzonin një jetë private dhe familjare të qetë. Gjykata argumentoi se aktiviteti i minierës dhe fabrikës kishtë ndikuar në problemet shëndetësore të kërkuësve dhe vendbanimet e tyre ishin prishur nga ndotja në zone. Gjykata pranoi se kishtë shkelje të nenit 8 të Konventës dhe detyroi qeverinë e Ukrainës për të marrë masa konkrete për të rregulluar situatën e krijuar. Të njëjtin qëndrim GjEDNJ mbajti edhe në çështjen Öneriyıldız kundër Turqisë.

Gjykimi *Guerra dhe të tjerë kundër Italisë*. Kërkuësit pretenduan që mungesa e masave për të reduktuar nivelet e ndotjes dhe parandalimin e situatave të tilla si pasojë e aktivitetit të uzinës cënonte të drejtën për jetën dhe integritetin fizik. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të KEDNJ dhe argumentoi se ndotja e rëndë e mjedisit kishtë cënuar mirëqënien e kërkuësve dhe të drejtën për të gëzuar një jetë familjare të qetë.

Gjykimi *Hamer kundër Belgjikës*. Gjykata u shpreh për herë të parë që, edhe duke mos e mbrojtur shprehimisht në Konventë, mjedisi është një vlerë në vetvete të cilën edhe shoqëria dhe autoritetet publike kanë interes për ta mbrojtur. Qëllimet ekonomike dhe madje edhe e drejta e pronës, nuk duhet të kenë përparësi përballë shqetësimeve mjedisore.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese¹ në çështjet me objekt mbrojtjen e mjedisit

Çështja me kërkuës Federatën Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim dhe Shoqatën e Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahut. Këto shoqata të cilësinë e grupimeve vullnetare bazuar të nenin 134/1/h të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pretenduan se ligji nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” nëpërmjet të cilit është vendosur ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë, me synim mbrojtjen e kafshëve të egra nga gjuetia pa leje e cila kërcënon zhdukjen e shumë specieve, për një periudhë të caktuar kohore është i papajtuëshëm me Kushtetutën, duke kërkuar shfuqizimin e tij. Pretendimet kryesore të tyre ishin se ky ligj cënonte parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private. Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të çështjes vlerësoi se ligji nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë” ka vendosur ndalimin e aktivitetit, por ai nuk ka parashikuar asnjë kufizim në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të subjekteve tregtare që merren me armët dhe materialet e gjuetisë. Sipas gjykatës, shoqatat nuk kanë arritur të argumentojnë se cili ishte dëmi real dhe i drejtpërdrejtë, që sillte ky ligj në veprimtarinë tregtare të anëtarëve të tyre. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese nëpërmjet vendimit nr. 36, datë 21.04.2017, arriti në përfundimin se pretendimet e shoqatave nuk ishin të bazuara, duke vendosur rrëzimin e kërkesës.

Gjykimi kushtetues me objekt papajtuëshmërinë me Kushtetutën të ligjit nr.5/2016, datë 4.2.2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, është iniciuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë, në kuadër të kontrollit incidental të normës ligjore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë, me vendimin e datës 20.3.2017 ka vendosur pezullimin e gjykimin të çështjes dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata ka pretenduar shfuqizimin e nenit 6/1 të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016 “Për shpalljen

¹ [ëëë.gjk.gov.al](http://eëë.gjk.gov.al)

e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimit nr.73, datë 17.11.2017, në këtë rast arriti në përfundimin se gjykata referuese nuk ka argumentuar nëse dispozita për të cilën kërkohet shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën është e vetmja që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe nëse ka bërë përpjekje për interpretimin e ligjit në pajtim me Kushtetutën, duke vendosur rrëzimin e kërkesës pa i hyrë themelit të gjykimit.

1.3. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë²

Në gjykimin e tre çështjeve administrative të iniciuara si aksion civil (nga individë dhe grupe interesi) të cilët kanë kërkuar në rrugë gjyqësore shfuqizimin e akteve administrative që lidhen me ndërtimin e hidrocentraleve pranë zonave të shpallura park kombëtar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka legjitimuar iniciimin e proceseve gjyqësore nga banorët e zonave dhe shoqatat që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Bazuar në standardet e parashikuara në Konventën e Aarhus-it, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë³ arsyeton se:

« Kolegji vlerëson se shtylla e tretë e Konventës së Aarhus-it përmban në vetvete tre element të rëndësishëm: 1. Mundësinë e legjitimitit aktiv për të vënë në lëvizje gjykatën; 2. Realizimin praktik të së drejtës, duke shmangur kostot e larta të procesit gjyqësor; 3. Mundësinë që vendimi gjyqësor të rivendos të drejtën e shkelur. Konventa referon në legjislacionin kombëtar në mënyrë që publikut t'i jepen të drejta më të zgjeruara për t'ju drejtuar gjykatës për çështje që kanë të bëjnë me qasjen në informacion apo pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimarrjes.

... E drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit dallon nga rastet e tjera të mosmarrëveshjeve gjyqësore, ku palët i drejtohen gjykatës për të kërkuar rivendosjes e një të drejte të shkelur. Çështjet mjedisore kanë një natyrë policentrike, larg aspektit formal kontradiktor dypalësh të një gjykimi të zakonshëm civil/administrativ.

Për shkak të natyrës së të drejtave të pretenduara të shkelura në çështjet mjedisore vështirësohet plotësimi i një prej kushteve thelbësore të ngritjes së padisë, interesi i drejtpërdrejtë, pasi në këto çështje mbrohen të drejta më karakter të përgjithshëm. ...Kolegji çmon se bazuar në interpretimin sistematik të parashikimeve dhe standardeve të Konventës së Aarhus-it, konkretisht nenit 9 të saj, si dhe në parashikimet e legjislacionit të brendshëm, shoqatat dhe grupet e interesit, si në rastin objekt gjykimi, gëzojnë legjitimitim aktiv në ngritjen e padive lidhur me çështjet mjedisore, sa kohë provohet një “interes i mjaftueshëm” në çështjen konkrete.”

Proceset gjyqësore në dy vendimarrjet e referuara janë përmbyllur në favor të aksionit civil të ndërmarrë nga grupet e interesit.

Jurisprudenca e Gjykatës Administrative të Tiranës

Pas fushatave të ndërgjegjësimit publik kombëtar dhe ndërkombëtar, një koalicion organizatash mjedisore (EcoAlbania nga Shqipëria, Riverëatch nga Austria dhe EuroNatur nga Gjermania) dhe 38 banorë të njësisë administrative Mallakastër shkuan në gjykatë kundër Ministrisë së

² [ëëë.gjykataelarte.gov.al](http://eëë.gjykataelarte.gov.al)

³ Vendimet nr. 00 – 2021 – 1177, datë 21.07.2021, nr. nr. 00-2021 – 1259, datë 30.07.2021, i Kolegjeve Administrative të Gjykatës së Lartë.

Energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në mbrojtje të luginës së lumit Vjosa, duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të procedurave të koncesionit, si dhe konstatimin e paligjshmërisë së kontratës me kompaninë "Kovlu Energji" për hidrocentralin në këtë lumë.

Fushatat e tyre sensibilizuan një yll ndërkombëtar si aktori Leonardo di Caprio, i cili u investua në vetë të parë⁴ ⁵ ⁶ në mbrojtje të « lumit Vjosa, një prej lumejve të fundit të egër të Evropës». Procesi gjyqësor u mbyll për këtë rast me një vendim përfundimtar në pro iniciativës së ndërmarrë nga grupet e interesit⁷, dhe ky vendim përbën rastin e parë të një procesi gjyqësor të iniciuar si një aksion social dhe i finalizuar me mbrojtjen e mjedisit. Aktualisht kjo zonë është shpallur park kombëtar.⁸ ⁹ ¹⁰ ¹¹

KUADRI INSTITUCIONAL

Paraqitje e autoriteteve administrative kombëtare

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjëse për miratimin e strategjive dhe politikave kombëtare mjedisore dhe lehtëson përafrimin me acquis mjedisore të BE-së. Po ashtu, ai është autoriteti menaxhues për Konventat Ndërkombëtare ku aderohet edhe Shqipëria. Meqenëse Shqipëria ka hapur tashmë negociatat e antarësimit në BE, përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin komunitar dhe përbushja e rekomandimeve të Komisionit Europian sa i takon Kapitujve respektiv përbën një objektivi për tu përbushur ky institucion. Konkretisht ndër objektivat afatshkurtër që duhet të përbushen nga ky institucion mund të referojmë: a) marrjen e masave për të rishikuar dhe përmirësuar strategjinë e ndikimit mjedisor dhe vlerësimet e impaktit mjedisor për projektet, planet dhe programet në sektorët e hidroenergjisë, ndërtimit, turizmit, transportit dhe minierave; b) forcimi i luftës kundër krimit mjedisor dhe politikave të zbatimit të ligjit për natyrën dhe mbrojtjen e biodiversitetit, veçanërisht në zonat e mbrojtura; c) forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet rritjes së profesionalizmit dhe mbështetjes buxhetore për të adresuar në mënyrë efektive krimet mjedisore.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për zhvillimin e ekonomisë së vendit përmes inkurajimit të bujqësisë, sipas sektorëve të programit për mbrojtjen e mjedisit, si peshkimi në mënyrë të kontrolluar, mbrojtja e diversitetit biologjik dhe e pyjeve, etj. Brenda Ministrisë së Bujqësisë ekziston Inspektoriati i peshkimit, me shtrirje lokale i cili është përgjegjës për inspektimin e peshkimit të paligjshëm.

⁴ <https://riveratch.eu/en/balkanrivers/nees/leonardo-dicaprio-raises-his-voice-vjosa>

⁵ <https://euronees.al/en/vjosa-national-park-noe-leonardo-dicaprio-reiterates-appeal-to-protect-area-from-dams/>

⁶ <https://ëëë.instagram.com/p/CMSVLFVllsT/?hl=en>

⁷ <https://ecoalbania.org/gjykata-ndalon-hidrocentralin-ne-vjose/?lang=en>

⁸ <https://ëëë.theguardian.com/environment/2023/mar/15/albania-vjosa-ëild-river-national-park-europe-first-aoe>

⁹ <https://ëëë.france24.com/en/live-nees/20230315-albania-s-ëild-river-granted-national-park-status>

¹⁰ <https://ëëë.nytimes.com/2023/09/18/travel/albania-vjosa-river-park.html>

¹¹ <https://ëëë.balkanrivers.net/en/vjosanationalparknoe>

Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u krijua në vitin 2014. Kjo Agjenci si një institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për mjedisin ka si mision për të mbrojtur, ruajtur dhe përmirësuar mjedisin, si një aset jetik për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, për të parandaluar dhe zvogëluar rreziqet për jetën dhe shëndetin e njeriut, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e jetës, përdorimin e kujdesshëm dhe racional të natyrës dhe burimeve të saj në kuadër të qëndrueshëm zhvillimin e vendit. Nga viti 2020, AKM ka nën varësi edhe strukturën inspektuese të mjedisit. Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit në AKM ka marrë përsipër disa nga përgjegjësitë e ish-Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Ujërave, Pyjeve dhe Turizmit. Gjithashtu, degët rajonale të AKM-së kanë në strukturën e tyre një drejtori të kontrollit dhe inspektimit mjedisor. Pra, AKM organizohet si organ qendror në nivel kombëtar me 4 agjenci rajonale të mbrojtjes së mjedisit dhe një staf prej 304 personash. AKM po ashtu monitoron dhe analizon e raporton të dhënat, si dhe është përgjegjëse për transferimin e mbetjeve, përfshirë mbetjet e rrezikshme. Për rolin e saj monitorues AKM raporton jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe tek disa organizata ndërkombëtare.

Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) është institucion në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përgjegjëse për verifikimin, licencimin (leje mjedisore), monitorimin dhe inspektimin e gjithë aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis. Aktualisht, në territorin e vendit operojnë 4 ARM. ARM-të ndjekin shkeljet administrative dhe njoftojnë policinë dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për shqyrtimin dhe ndjekjen e shkeljeve që përbëjnë vepër penale. Inspektimet bëhen sipas planeve vjetore e mujore duke përdorur një model standard për raportin e inspektimit në terren i cili plotësohet online.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), e themeluar në vitin 2015, është një ent publik i krijuar si institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përgjegjës për sistemin e zonave të mbrojtura të vendit. Ligji i Zonave të Mbrojtura i njej drejtorit të AKZM dhe shefit të sektorit të monitorimit autoritetin e oficerit të policisë gjyqësore (OPGJ).

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion qendror, përgjegjës për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji. Inspektimi mjedisor synon zbatimin e legjislacionit mjedisor në zonën objekt kontrolli, përputhshmërinë e veprimtarisë së inspektuar me kërkesat ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) është krijuar në vitin 2020, në vijim të përpjekjeve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për përmirësimin dhe forcimin e sektorit të menaxhimit të pyjeve, përfshirë edhe zbatimin e ligjshmërisë. Në këto dy vite, detyra kryesore e AKP-së ka qenë konsolidimi i strukturave dhe garantimi i zbatimit të kuadrit ligjor për pyjet.

Struktura e Policisë Pyjore është organ i specializuar i shërbimit pyjor përgjegjës për kontrollin e zbatimit të detyrimeve ligjore, monitorimin e veprimtarive të ligjshme dhe për parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme që çënojnë fondin pyjor. Inspektorët e Policisë Pyjore kanë të gjitha të drejtat, për të inspektuar si dhe për të marrë masat e bllokimit të aktivitetit apo sekuestrimit, në rastet e shkeljes së ligjit. Në përmbushje të detyrës ata gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore. Vendimi për ndëshkimin me gjobë të subjekteve që kryerjen kundërvajtje administrative merret nga Policia Pyjore, e cila për çdo rast vlerëson dhe dëmin që është shkaktuar. Të drejtën për të kërkuar në rrugë gjyqësore shpërbllimin e dëmit e ka struktura menaxhuese e sipërfaqeve pyjore, pronë shtetërore, ose bashkia përkatëse që kanë pronësi sipërfaqen pyjore, në të cilën ka ndodhur kundërvajtja.

Agjencia Menaxhimit të Burimeve Ujore. Agjencia Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është krijuar në vitin 2018. Misioni i Agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe priorizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e rregullave në lidhje me importin dhe eksportin dhe njëkohësisht i raporton prokurorisë në rastet e identifikimit të shkeljeve kundër mjedisit, si dhe raporton çdo vit në Zyrën e Kimikateve (të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit) të dhënat e vitit të kaluar për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme.

Bashkitë. Bashkitë janë një institucion thelbësor në kontrollin e territorit dhe menaxhimin e burimeve natyrore në nivel vendor. Në varësi të madhësisë dhe shtrirjes së burimeve natyrore, Bashkitë kanë krijuar drejtori apo sektorë që janë përgjegjës për ndjekjen e problematikave mjedisore dhe menaxhimin e burimeve natyrore që janë nën juridiksionin e tyre. Si pjesë e administratës së Bashkive janë ngritur dhe funksionojnë Policia Bashkiake dhe Inspektorati i Kontrollit të Territorit.

Autoritete të tjera dhe Institucionet Akademike

Avokati i Popullit. Avokati i Popullit ka monitoruar situatën mjedisore në Republikën e Shqipërisë, si edhe zbatimin e legjislacionit respektiv në këtë fushë nga institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore. Gjatë viteve 2020- 2022 janë trajtuar gjithsej 91 ankesa ndaj organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm të çështjeve të filluar me iniciativë nga vetë institucioni.

Gjatë kësaj periudhe AP ka nxjerrë rekomandime për problematika të lidhura me trajtimin e mbetjeve spitalore dhe për disa situata problematike si ndotja nga mbeturinat apo derdhja e nënprodukteve të naftës. Bazuar në legjislacionin e posaçëm Avokati i Popullit ka vetëm funksione monitoruese dhe rekomanduese ndaj veprimtarisë së institucioneve të administratës publike.

Shkolla e Magjistraturës mundëson rekrutimin dhe formimin fillestar të kandidatëve për magjistratë, formimin e vazhdueshëm profesional të magjistratëve në detyrë, si dhe zhvillon testime për këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësit ligjorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Shkolla e Magjistraturës, si pjesë e veprimtarisë së saj kryen trajnime të vazhdueshme, por nuk janë specifike për krimin mjedisor. Magjistratët në programin shkollor i dedikohen hetimit dhe ndjekjes gjyqësore të krimeve kundër mjedisit për vetëm 3 ditë, ndërsa sa i përket formimit të vazhdueshëm, ka pasur vetëm një trajnim lidhur me krimin mjedisor të organizuar në tetor të vitit 2022. Ka një zhvillim pozitiv për vitin e ardhshëm akademik në Shkollën e Magjistraturës. Si pjesë e programit të formimit fillestar të magjistratëve për vitin 2023-2024 do të jetë edhe një kurs mbi aspektet administrative, civile dhe penale të legjislacionit ndërkombëtar dhe vendas në fushën e mjedisit. Ky program është hartuar me mbështetjen e prezencës së OSBE¹² në Shqipëri, nga një grup i përbashkët i ekspertëve vendas dhe të huaj në këtë fushë. Ky kurs do të organizohet në 40 orë dhe do të mbulojë 15 tema specifike.

Akademia e Sigurisë është pjesë e Policisë së Shtetit Shqiptar, e fokusuar në edukimin, specializimin dhe trajnimin e oficerëve dhe agjentëve të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese. Akademia ofron programe studimi dhe kurse specializimi dhe trajnime mbi policimin, zbatimin e ligjit dhe çështjet e sigurisë. Tematika e veprave kundër mjedisit trajtohen si në programin bazë dhe në trajnimin e vazhduar për oficerë dhe agjentë të karrierës. Aktualisht, ngarkesa e trajnimit të temave dhe veprave kundër mjedisit është vetëm 3 orë për trajnimin e vazhduar dhe qëllimi është që në 2023, këto tematika të pasurohen për programin e trajnimit të vazhduar.

Autoritet e specializuara të gjyqësorit

Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Kolegji Penal e Civil i Gjykatës së Lartë gjykojnë veprat penale në fushën e mjedisit si dhe çështjes civile me objekt shpërblim dëmi të shkaktuar nga veprimtaria mjedisore. Ndërkohë **gjykatat administrative të shkallëve të para, Gjykata Administrative të Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë** gjykojnë çështjet administrative që lidhen me kundërshtimin/shfuqizimin e akteve administrative të nxjerra nga institucionet e administratës shtetërore apo dhe paditë e ngritura nga shoqatat që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm ushtrojnë ndjekjen penale të rasteve të kallëzuara nga qytetarët, nëpunësit publikë ose të referuara nga policia gjyqësore si dhe përfaqësojnë akuzën në gjyq në emër të shtetit dhe merr masa e mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale. Në rastet e identifikimit të veprave penale kundër mjedisit, është detyra e institucionit kompetent publik ta raportojë çështjen në prokurori dhe kjo e fundit, për këtë qëllim, duhet ta ketë shumë qartë diferencën midis veprës që konsiderohet shkelje administrative dhe merr si dënim masë administrative apo nëse njihet si vepër penale.

¹² [Baseline assessment on the inspection, investigation and punishment of environmental contraventions and crimes in Albania | OSCE](#)

Prokuroria e Përgjithshme përfaqësohet nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili në bazë të nenit 38 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i cili ka di kompetencave kryesore përfaqësimin e akuzës në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese ; nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre; sigurimin e mbarëvajtjes së punës në administratën e prokurorisë së juridiksionit të Përgjithshëm etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në varësi të Ministrisë së Brendshme, ka si prioritet të punës luftën kundër kriminalitetit në të gjithë vendin. Kontrollin e territorit me synim parandalimin e goditjen e krimit mjedisor dhe në mënyrë të veçantë evidentimin e ndërtimeve pa leje dhe procedimin e vënien para drejtësisë e autorëve të tyre. Policia e Shtetit ka rol parësor në gjetjen dhe raportimin e krimit kundër mjedisit. Punonjësit e Policisë së shtetit kanë dhe një rol të rëndësishëm në hetimin e veprave penale nëpërmjet oficerëve të policisë gjyqësore. Funksionet e Policisë Gjyqësore në Shqipëri kryhen nga seksionet e policisë gjyqësore, të ngritura pranë prokurorive dhe nga shërbimet e policisë gjyqësore, të organizuara në strukturat hetimore të Policisë së Shtetit ose Policisë Kufitare dhe në institucionet e tjera shtetërore të cilave ligji u njuh te drejtën e ushtrimit të funksioneve të policisë gjyqësore, sikurse janë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Policia Ushtarake, etj.

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Aarhusit në 26 Tetor të vitit 2000. Në kuadër të zbatimit të angazhimeve të parashikuara në këtë Konventë me mbështetjen e OSBE janë ngritur 3 Qendrat e Informacionit Aarhus me bazë në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Këto tri qendra mbështesin Ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj në sigurimin e informacionit mjedisor, si dhe promovojnë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa në mënyrë të vazhdueshme. Tri qendrat kanë bërë një sërë fushatash të ndërgjegjësuese mbi 3 shtyllat kryesore të Konventës.

Në lidhje shtyllën e parë që parashikon të drejtën e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor, zbatimi i saj sigurohet në mënyrë efektive nga kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtën e informimit. Kuadri rregullator siguron që informacioni mjedisor të shpërndahet në mënyrë sistematike, që publiku të informohet periodikisht mbi çështjet mjedisore, të shkëmbejë opinionin dhe të sigurohet pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje.

Duke garantuar harmonizimin me përcaktimet e Konventës aksesin në informacion mbi çështjet mjedisore i sigurohet personave, fizikë apo juridikë, shoqatave, organizatave dhe grupimeve të tyre. E parë si një e drejtë e komunitetit në tërësi për të marrë informacion mbi çështjet mjedisore legjislativi konfirmon edhe rolin e veçantë të shoqërisë civile. Pavarësisht kësaj, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen për projekte të rëndësishme me impakt mjedisor pavarësisht garantimit të saj nga legjislativi nuk zbatohet në mënyrë efektive.

Kuadri regullator në fuqi ka krijuar hapësirat dhe mundësitë ligjore për iniciimin e gjykimeve nga aktorët e shoqërisë civile apo grupet e interesit. Shoqatat¹³ sikundër analizuam më sipër, kanë qënë promotorë të aksioneve civile pranë gjykatave administrative duke iniciuar procese gjyqësore me impakt mjedisor dhe duke kontribuar në krijimin dhe konsolidimin e jurisprudencës gjyqësore në funksion të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Aarhusit, lidhur me shtyllën e tretë atë që lidhet me të drejtën e aksesit në drejtësi për çështjet mjedisore.

Përveç punës individuale të organizatave të caktuara që operojnë në fushën e mjedisit dhe që trajtojnë aspekte të ndryshme të krimit mjedisor, Organizat Jofitimprurëse janë organizuar në rrjete, siç është rasti i nismës së Grupit Këshillimor Kundër Krimit Mjedor i Organizatave të Shoqërisë Civile (GKKKM) i cili u krijua në fund të vitit 2019, me iniciativën dhe mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Ky grupim është një organizëm jo formal, i pavarur dhe vullnetar i 18 ekspertëve mjedisorë, organizatave të shoqërisë civile dhe gazetarëve që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin në nivel qendror dhe lokal, për të ndihmuar në avancimin e politikave të qeverisë në luftën kundër krimit mjedisor, duke bashkëpunuar me autoritetet përgjegjëse dhe komunitetet me synim adresimin e krimit mjedisor. Grupimi funksionon në bazë të takimeve periodike dhe ka një kontribut në ndërtimin e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet politikëbërëse mjedisore.

TË DHËNA STATISTIKORE

Të dhëna statistikore për veprat penale në fushën e mjedisit

Nga të dhënat statistikore të administruara deri më tani, për periudhën kohore 2019-2021 rezulton se ka një tendencë në rritje të vendimeve të dhëna nga gjykata për veprat penale në fushën e mjedisit. Gjatë këtij harku kohor rezulton se vepra penale që zë peshën specifike më të madhe në grupin e veprave penale kundër mjedisit është “Prerja e paligjshme e pyjeve” pesha e së cilës është 61,28 % gjatë vitit 2019, 55.89 % gjatë vitit 2020, 47.13 % gjatë vitit 2021 dhe 52.69% në vitin 2022.

Vepra të tjera penale si "Ndotja e ajrit, e ujrave dhe e tokës", dhe "Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore", zënë një peshë të konsiderueshme në kategorinë e krimeve mjedisore prej 10-40 % përgjatë këtij harku kohor.

Bazuar në të dhënat statistikore të administruara deri më tani rezulton se:

Në lidhje me veprimtarinë hetimore:

¹³ Shoqata e “Bujqësisë Organike”, “Shoqata Toka” (Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Alpeve Shqiptare”, EcoAlbania

a) **Gjatë vitit 2019**¹⁴ vërehet një rritje e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprat penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2018. Gjatë këtij viti ka një rritje prej 7,69 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit dhe ulje prej 15,38 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar prej 19,33%. Vepra penale që zë peshën specifike më të madhe në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” për vitin 2019 është “Prerja e paligjshme e pyjeve”.

b) **Gjatë vitit 2020**¹⁵ vërehet një rritje e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprat penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2019. Gjatë këtij viti ka një rritje prej 24,44 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2019 dhe ulje prej 3,03 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Vepra penale që zë peshën specifike më të madhe në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” edhe përgjatë vitit 2020 është “Prerja e paligjshme e pyjeve” Njëkohësisht përgjatë këtij viti vërehet një rritje e numrit të procedimeve penale të hetuara dhe gjykuar për veprën penale të “ndotjes së ajrit”.

c) **Gjatë vitit 2021**¹⁶ vërehet një ulje e lehtë e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprat penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2020. Gjatë këtij viti ka një ulje prej 5,41 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit dhe rritje prej 25 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Gjatë këtij viti vërehet një rritje e numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim prej 27,14 % dhe rritje e numrit të të dënuarve për krimet mjedisore me 38,29 %. Vepra penale që zë peshën specifike më të madhe në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” edhe përgjatë vitit 2021 është “Prerja e paligjshme e pyjeve”.

d) **Gjatë vitit 2022**¹⁷ vërehet një rritje e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprat penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2021. Gjatë këtij viti ka një rritje prej 18,47% të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprat penale kundër mjedisit dhe ulje prej 6,25% të procedimeve të dërguara në gjykatë. Gjatë këtij viti vërehet një rritje e numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim prej 15,73 % dhe rritje e numrit të të dënuarve për krimet mjedisore me 12,31 %, krahasuar me vitin 2021.

Në lidhje me gjykimet rezultojnë se:

a) **Gjatë vitit 2019**¹⁸ në lidhje me llojin dhe masën e dënimit rezultojnë se: në 89 % të rasteve është dhënë vendim fajësie në 7 % të rasteve është dhënë një vendim pafajësie, në 2 % të rasteve është vendosur pushimi i çështjes dhe në 1 rast është vendosur kthimi për hetime të mëtejshme.

b) **Gjatë vitit 2020**¹⁹ në lidhje me llojin dhe masën e dënimit rezultojnë se në 53,22 % të rasteve është caktuar masa e dënimit me burgim ku gjykata në të gjitha rastet ka aplikuar masat alternative të dënimit duke pezulluar dënimin dhe vendosur në provë të dënuarit dhe në 44,68% të rasteve është caktuar masa e dënimit me gjobë. Në asnjë rast nuk ka patur kthim për rihetim.

¹⁴ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2019

¹⁵ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2020

¹⁶ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021

¹⁷ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2022

¹⁸ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2019

¹⁹ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2020

c) *Gjatë vitit 2021*²⁰ në lidhje me llojin dhe masën e dënimit rezulton se në 70.77 % të rasteve është caktuar masa e dënimit me burgim ku gjykata në pjesën më të madhe të tyre ka aplikuar masat alternative të dënimit duke pezulluar dënimin dhe vendosur në provë të dënuar in në një rast është vendosur pafajsi dhe në një rast pushimi i çështjes dhe në 29.23 % të rasteve është caktuar masa e dënimit me gjobë.

d) *Gjatë vitit 2022*²¹ në lidhje me llojin dhe masën e dënimit rezulton se në 41.09 % të rasteve është caktuar masa e dënimit me gjobë dhe në 58.91% është caktuar masa e dënimit me burgim ku gjykata në 90.7% të tyre ka aplikuar masat alternative të dënimit duke pezulluar dënimin dhe vendosur në provë të dënuar in. Në 5 raste është vendosur pafajsi dhe në një rast pushimi i çështjes.

7.2. Të dhëna statistike për gjykimet administrative

Në lidhje me çështjet administrative të gjykuara me vendim të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit mund të referojmë 23 çështje përgjatë harkut kohor 2019-2021. Ndërkohë sa i takon çështjeve civile deri tani nuk ka raportime për gjykime të kësaj natyre. Me ngritjen e gjykatave administrative²² shqyrtimi i çështjeve ndaj akteve administrative dhe shpërblimit të dëmit kur palë është një organ i administratës publike është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

SPECIALIZIMI I AUTORITEVE GJYQËSORE DHE ORGANEVE TË TJERA LIGJZBATUESE

Referuar legjisllacionit në fuqi sa i takon organizimit gjyqësor²³ rezulton se Shqipëria nuk ka gjykata të specializuara apo seksione të specializuara pranë gjykatave për gjykimin e çështjeve mjedisore. Pavarësisht kësaj, rregullat procedurale të gjykimin të parashikuara në Kodet respektive në varësi të natyrës së gjykimin, parashikojnë mundësinë që gjatë gjykimin të kërkohet ekspertiza e një ose më shumë ekspertëve, për konsatimin apo sqarimin e fakteve që janë të lidhura me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Në regjistrin elektronik të ekspertëve që caktohen nga gjykata ka ekspertë të licencuar për ndikimin në mjedis dhe auditimin mjedisor. Në varësi të natyrës së gjykimin dhe impaktit që ky gjykim mund të ketë në interesin publik gjykata mund të kërkojë thirrjen si person të tretë të subjekteve që kanë interes në çështjen në gjykim. Njëkohësisht çdo individ apo person juridik (siç mund të jenë shoqatat në fushën e mbrojtjes së mjedisit) kur kanë interes për të mbështetur njërin nga palët mund të kërkojnë të thirret në gjykim si person i tretë derisa nuk është vendosur caktimi i senacës gjyqësore. Ky rregull aplikohet për gjykimet civile dhe administrative në përputhje me rregullat procedurale.

²⁰ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021

²¹ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2022

²² Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

²³ Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin dhe funksionin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Referuar legjislacionit në fuqi për organizimin e sistemit të prokurorisë²⁴ dhe akteve nënligjore përkatëse, rezulton se nuk ka prokurori të specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e mjedisit apo seksione të specializuara për hetimin e kësaj kategorie veprash penale. Pavarësisht kësaj në funksion të veprimtarisë hetimore dispozitat procedurale penale parashikojnë të drejtën e organit procedues për të caktuar një ose disa ekspertë nëse është e nevojshme për zhvillimin e kërkimeve ose marrjen e të dhënave që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore. Në përputhje me dispozitat procedurale prokurorët delegojnë ose urdhërojnë oficerët e policisë gjyqësore për kryerjen e çdo veprimi hetimor.

Sa i përket vetë burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, një nga kërkesat e paraqitura nga organet e policisë në BE (Europol) është krijimi i një grupi të dedikuar pune për krimet mjedisore.

Deri tani nuk janë kryer trajnime të mirëfillta lidhur me krimin mjedisor kryesisht përse i përket kuadrit ligjor, procedurave të hetimit dhe kontrollit. Për sa i takon specializimit të inspektorëve të mjedisit në fushën e pyjeve ka pasur një interes në rritje për trajnime që lidhen me kundërvajtjet mjedisore, kryesisht të mbështetura nga donatorët e huaj. Ka pasur disa raste kur ekspertë të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve janë thirrur për të trajnuar përfaqësues të organeve të sigurisë lidhur me ligjshmërinë dhe problematikat e krimit në pyje. Prokuroria e Përgjithshme²⁵ në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, identifikonte se temat ku vlerësohet se duhet të thellohen njohuritë e tyre, ndër të tjera përfshijë dhe veprat penale në fushën e mjedisit.

BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI I VEPRIMTARISË SË AUTORITETEVE QË VEPROJNË NË FUSHËN E MBROJTJES SË MJEDISIT

Sa i përket bashkëpunimit midis policisë, prokurorisë, gjykatave, institucioneve dhe agjencive të administratës publike në kuadër të luftës kundër krimit mjedisor, ai është i vazhdueshëm, megjithatë, nuk ka një përcaktim shumë të qartë në ligj ose në praktikë se cila nga institucionet duhet të veprojë në momente të caktuara.

Në vlerësimin e ekspertëve duke qënë e legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit ngarkon organet administrative për evidentimin dhe përcaktimin e llojit të shkeljes, vlerësimin e dëmit/ndotjes, caktimin e masave administrative ndaj kundërvajtësve administrativ, kallëzimin në prokurori kur vlerësohet se është vepër penale, kuptohet që janë këto organe që duhet të veprojnë fillimisht. Ushtrimi i ndjekjes penale nga prokuroria kryhet për ato shkelje të ligjit të cilat nuk parashikohen si kundërvajtje administrative.

Mekanizmat e vendosur për të inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet strukturave shtetërore që kanë funksione inspektuese dhe hetuese ende mungojnë.

Ndërveprimi ndërinstitutional nuk është i rregullt dhe efektiv (në lidhje me inspektimin e pyjeve, ujit dhe ndotjes nga industria), si në rastin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Kombëtar të Menaxhimit të Territorit dhe degëve rajonale të tyre. Si rrjedhojë institucionet e tjera, kanë vështirësi në identifikimin e institucionit të cilit duhet ti drejtohen në rastin e evidentimit të një krimi mjedisor në terren.

²⁴ Ligji nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

²⁵ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm Mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2021

Nevojitet një bashkëpunim më i ngushtë me organet gjyqësore dhe rritje e ndërgjegjësimit dhe informimit të tyre për rëndësinë e ndjekjes së duhur të krimeve mjedisore. Specialistët e agjencive për mbrojtjen e mjedisit nuk janë thirrur nga gjykata në rolin e ekspertit për çështje që lidhen me krimin mjedisor. Nuk ka pasur raste të thirrjes së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve si ekspertë në proceset gjyqësore që lidhen me pyjet, ndërkohë që strukturat e bashkisë janë thirrur disa herë.

Bashkëpunimi me policinë dhe prokurorinë është i mirë. P.sh., së fundmi, Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier është përfshirë në një grup pune të përbashkët për hetimin e krimeve mjedisore. Specialistët/inspektorët e kësaj agjencie janë thirrur nga policia për verifikimin e rasteve të shkeljeve mjedisore. Po ashtu, inspektorët thirren në gjykatë për të mbrojtur vlerësimet/konstatimet e rasteve të inspektuara.

BASHKËPUNIMI GJYQËSOR

Parimi i bashkëpunimit midis shteteve është theksuar që në preambulën e Kushtetutës së Shqipërisë ku thuhet se «drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit».

Konventat Shumëpalëshe

Globalizimi i veprimtarive kriminale ka krijuar një nevojë për të forcuara të bashkëpunimin ndërkombëtar. Hetimi, ndjekja penale dhe kontrolli i krimit nuk mund të kufizohen brenda kufijve kombëtar. Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale ka një bazë të fortë në marrëveshje shumëpalëshe, të cilat përcaktojnë dispozitat e ndihmës juridike për autoritetet gjyqësore të vendeve për të lehtësuar bashkëpunimin veçanërisht në luftimin e krimit të organizuar. Këto marrëveshje shumëpalëshe sigurojnë informacionin e nevojshëm ligjor dhe praktik për autoritetet gjyqësore të vendit të tyre, si dhe për lidhjet dhe autoritetet gjyqësore të vendeve të tjera. Të gjitha konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, pas ratifikimit me ligj, bëhen pjesë e sistemit juridik të brendshëm dhe mbizotërojnë mbi ligjin e brendshëm në rast konflikti ose papajtueshmërie. Shqipëria ka nënshkruar disa Konventa dhe Rezoluta të rëndësishme të OKB-së, Konventa dhe Marrëveshje të Këshillit të Evropës (KE) mbi bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe marrëveshja dypalëshe të bashkëpunimit të ndërsjelltë gjyqësor në fushën penale. Në nivelin kombëtar bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale është rregulluar nëpërmjet parashikimeve të bërë në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale. Në vitet e fundit veprimtaria kriminale ka kapërcyer kufijtë kombëtarë duke u bërë gjithnjë e më shumë një sfidë në nivel rajonal dhe atë ndërkombëtarë.

Shqipëria tashmë ka një kornizë të plotësuar ligjore në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale. Mbetet që autoritetet të forcojnë zbatimin dhe të forcojnë praktikën gjyqësore në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

Në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar lidhur me veprat penale në fushën e mjedisit rezulton se gjatë vitit 2022 është dërguar 1 letërporosi nga autoritetet e huaja dhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 janë dërguar 2 letërporosi. Këto leërporosi janë përcjellë për ekzekutim në përputhje me dispozitat procedurale penale dhe legjislacionin në fuqi pranë prokurive respektive.

PROBLEMATIKAT DHE PRAKTIKAT E MIRA

Republika e Shqipërisë ka një kuadër ligjor rregullator në fushën e mbrojtjes së mjedisit, i cili është i përafuar në pjesën më të madhe me tej me acqius communatire të Bashkimit Evropian. Njëkohësisht ratifikimi marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore dhe aderimi në Konventat Ndërkombëtare në fushën e mjedisit është tregues i rëndësisë politike që Shqipëria i kushton bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet mjedisore.

Ka dy momente që dëshmojnë angazhimin e Shqipërisë në iniciativat europiane dhe rajonale në mbrojtje të mjedisit :

Axhenda e gjelbër për Ballkanin Perëndimor

Është një instrument i krijuar në kuadër të Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së, në të cilën vlerësohet se cdo aksion mund të jetë plotësisht efektiv, vetëm nëse ndërmerren veprime të ngjashme edhe përtej kufijve administrativë të Bashkimit Evropian.

Objektivi kryesor i kësaj agjende është caktimi i neutralitetit në ndikimin për klimën për vitin 2050 edhe në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, të cilat janë në procesin e para-anëtarësimit. Arritja e neutralitetit klimatik në vitin 2050, si hap i parë kërkon uljen e emetimeve të gazeve serrë me 55% deri në vitin 2030.

Drejtuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor ranë dakord të miratojnë objektivat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, më 10 nëntor 2020, në Samitin e rradhës së Procesit të Berlinit (një iniciativë e Gjermanisë), duke nënshkruar Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (Deklarata e Sofjes)²⁶ dhe dy vjet më vonë, Gjermania inicioi në Samitin e rradhës në Berlin, “Partneritetin e klimës në Ballkanin Perëndimor”, për zhvillimin e një plani rajonal të energjisë dhe klimës me qëllim rritjen e mbështetjes dhe bashkëpunimin teknik dhe financiar mes Gjermanisë dhe rajonit, për të krijuar kushtet e nevojshme për implementimin e axhendës së gjelbër europiane,²⁷ shoqëruar me angazhimin e Komisionit Evropian në mbështetje të rajonit përmes një pakete financiare të dedikuar për Mbështetjen e Energjisë, si dhe një vazhdimësi të masash të tjera.²⁸

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është krijuar rreth pesë shtyllave kryesore të mëposhtme të cilat mbartin detyrimet për secilin shtet nënshkrues:

- Burimet e energjisë së pastër dhe mbrojtja e klimës
- Lëvizja drejt një ekonomie qarkulluese
- C’ndotja e ajrit, ujit dhe tokës

²⁶ <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-ëestern-balkans-ru>

²⁷ https://www.berlinprocess.de/uploads/documents/declaration-on-energy-security-and-green-transition-in-the-ëestern-balkans_1686662497.pdf

²⁸ https://www.berlinprocess.de/uploads/documents/annex-to-the-declaration-on-energy-security-and-green-transition-in-the-ëestern-balkans_1686662510.pdf

- Ndërtimi i sistemeve të qëndrueshme të bujqësisë dhe ushqimit
- Mbrojtja e biodiversitetit dhe e ekosistemeve

Procesi i negociatave për antarësimin në Bashkimin Evropian

Shqipëria ka filluar procesin e negociatave të antarësimit me Bashkimin Evropian më 19 korrik 2022, menjëherë pas Konferencës Ndërqeveritare. Cështjet e Axhendës së Gjellbër dhe lidhjeve të qëndrueshme negociohen vecmas në një grup-kapitujsh që përfshijnë “Transporti” (Kapitulli 14), “Energjia” (Kapitulli 15), “Rrjetet Trans-Europiane”(Kapitulli 21) si dhe “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike” (Kapitulli 27).

Pavarësisht këtij angazhimi të Shqipërisë, problematikat konstatohen në lidhje me zbatimin e këtij kadri rregullator në praktikë. Shumë akte ligjore nuk kanë një praktike të hartimit të raporteve të zbatimit të tyre. Legjislacioni është shumë i avancuar për kapacitetet administrative, financiare dhe institucionale. Kjo vihet re dhe në mungesën e progresit lidhur me fushën e përgjegjësisë mjedisore, inspektimit mjedisor dhe krimit mjedisor.

Progres Raporti i BE “Për Shqipërinë në 2022” evidentoi një rritje në hetimin e krimeve mjedisore, duke theksuar gjithsesi nevojën për më shumë vëmendje në mbrojtje të mjedisit sidomos gjatë miratimit të investimeve private dhe në mbrojtjen e zonave me habitate të specieve të veçanta.

Të dhënat statistike të referuara në lidhje me kategorinë e veprave penale në fushën e krimit mjedisor tregojnë se Vepra penale që zë peshën specifike më të madhe në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është “Prerja e paligjshme e pyjeve” e ndjekur “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës” dhe “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”. Pavarësisht numrit në rritje të procedimeve penale për këtë kategori veprash veprash konstatohet se dënimet e dhëna nga gjykata janë dënime me gjobë ose në rastin e dënimeve me burgim në mbi 90 përqind të tyre është vendosur pezullimi i ekzekutimit dhe aplikimi i instituteve alternative të dënimit. Në këtë aspekt politika penale në drejtim të dënimit të krimeve mjedisore duhet të rishikohet. Dënimit me gjobë në një pjesë të konsiderueshme të rasteve kur personat e proceduar penalisht për këto vepra penale i përkasin grupeve shoqërore me probleme social-ekonomike është joefektiv. Politika penale në këto raste duhet të ketë në fokus jo vetëm ndëshkimin me gjoba që në një pjesë të rasteve janë të papërballueshme nga të dënuarit, por kryesisht edukimin e tyre për parandalimin e kryerjes së veprave penale në të ardhmen.

Njëkohësisht edhe në rastin e konstatimit të shkeljeve administrative, detyra e autoriteve administrative nuk duhet të përfundojë më konstatimin e shkeljes, vendosjen e masës administrative apo paraqitjen e kallëzimit penal. Nevojitet një angazhim më i madh nga ana e inspektorëve dhe ekspertëve që punojnë pranë organeve administrative për ndërgjegjësimin për natyrën e krimit mjedisor, ndikimin përkatës dhe dinamikën e tij, dëmin që i shkaktohet mjedisit dhe shëndetit të brezave aktual dhe të ardhshëm nga kjo kategori veprash penale apo shkelje administrative. Qëllimi i legjislacionit është parandalimi, pastaj ndëshkimi administrativ dhe pastaj ai penal.

Në lidhje me inspektimin mjedisor, shumë institucione përgjegjëse kanë paqartësi të kompetencave në aspekte të ndryshme të inspektimit (IKMT, AKP, Bashkitë) ndërsa të tjera nuk e ushtrojnë të drejtën ligjore për shkak të akteve sekondare. Në këtë kontekst, Inspektorët e mjedisit në radhë të parë dhe më pas prokurorët dhe oficerët e policisë do të duhet të asistohen me trajnime se si të provojnë lidhjen shkakësore midis krimit të tillë si ndotja e ajrit, ndotja e ujit ose shkatërrimi i pyjeve dhe pasojave të rënda të shkaktuara në shëndetin ose jetën e njerëzve.

Mungesa e një rregullimi ligjor të drejtpërdrejtë dhe të qartë lidhur me vijën ndarëse midis shkeljes administrative dhe vepër penale. Kjo është e nevojshme edhe duke parë referencat e kryqëzuara (administrative dhe penale) nga ana e legjislacionit të posaçëm që shpesh në dispozitat e ndëshkimeve administrative përdor, shprehjen “kur nuk përbën vepër penale, është shkelje administrative”. Kjo shprehje në vetvete nuk tregon ndarje të qartë të këtyre përgjegjësive, pasi ndarja bëhet duke lexuar në harmoni ligjin e posaçëm dhe Kodin Penal.

Një problematikë tjetër është dhe kuantifikimi i dëmit mjedisor shkaktuar nga ndotja e mjedisit, siç mund të jetë ajri dhe uji, me qëllim zbatimin e parimit “ndotësi-paguan” dhe kërkesës për pagimin e dëmit. Duke mos patur një panoramë të qartë të parashikimeve mbi shkeljet dhe përgjegjësinë/saksionet e legjislacionit administrativ në fushën e mjedisit, nuk mund të konkludohet për parashikimin nga legjislatori të përgjegjësive dyfishe (administrative dhe penale) për shkeljet e kryera në fushën e mjedisit. Në një aspekt tjetër, megjithëse përgjegjësia e personave juridikë përcaktohet në ligj të posaçëm ndëshkimet e këtyre të fundit në fushën e krimit mjedisor nuk duken efektive apo proporcionale, pasi maksimumi i gjobës për personat juridikë është më i ulët se gjoba maksimale për individët që kryejnë të njëjtën kundërvajtje. Kjo ndodh sepse përcaktimi i dënimit bëhet rast pas rasti dhe ndarja midis kundërvajtjes administrative dhe asaj penale mbetet në diskrecion të organeve përgjegjëse për identifikimin dhe ndëshkimin e veprave të paligjshme kundër mjedisit. Kjo përbën një detyrë të inspektorateve të cilat duhet ta vënë këtë informacion në dispozicion të jo vetëm gjatë ushtrimit të ndjekjes penale nga prokuroria, por duhet të investojnë gjykatën për të kërkuar shpërblimin e dëmit në rrugë civile jo vetëm nga personat e dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër mjedisit por edhe ndaj personave që kanë kryer shkelje të natyrës administrative.

REKOMANDIMET KOMBËTARE

Rekomandime të natyrës legislative

- a) Amendimi i dispozitave të Kodit Penal në dy këndvështrime: me qëllim kriminalizimin e veprimtarive të tjera dëmtuese të mjedisit, që rezultojnë nga praktika e vendeve të rajonit dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian duke sjellë Kodin Penal në standardin e duhur të luftës kundër krimeve mjedisore dhe harmonizimin e dispozitave të Kodit me rritje dhe ndryshimet që të do sjellë direktiva e re “Për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal » pas miratimit të saj nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli.
- b) Të analizohet mundësia që një kategori e caktuar e krimeve mjedisore të njihet si formë e krimit të organizuar. Kjo mundëson një rritje të mjeteve dhe burimeve të hetimit duke mundësuar fillimin e hetimeve për krime ndërkufitare dhe një rritje të efikasitetit në reagimin e menjëhershëm kundër krimeve mjedisore në veçanti nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë me agjensitë ndërkombëtare ligjzbatuese.

- c) Përcaktimi i qartë i ndryshimeve ndërmjet shkeljeve administrative dhe atyre penale për të mos lënë asnjë hapësirë për zbatim të ndryshëm në situata të ngjashme. Formulimi i dispozitave ligjore në ligjet e posaçme për mbrojtjen e mjedisit, jo vetëm nuk duhet të krijojë mbivendosje me parashikimet e Kodit Penal, por duhet të qartësojë pa ekuivoke llojin, tipin e shkeljes dhe vlerën apo kufirin e nivelit të ndotjes apo dëmit të mjedisit, për cila shkelësit duhet të mbajnë përgjegjësi administrative, për të garantuar efikasitet më të lartë në sanksionimin e shkelësve.
- d) Hartimi i një plani strategjik kundër krimit mjedisor, i cili mund të përcaktojë rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve administrative dhe ligjzbatuese në mbrojtjen e mjedisit dhe luftën kundër krimeve mjedisore, objektivat strategjik dhe mënyrën e realizimit të tyre si burimet e duhura financiare të shoqëruar nga një plan veprimi i cili të detajojë në masa dhe afate konkrete realizimin e këtyre objektivave.
- e) Parashikimi i saktë dhe i qartë në ligjet e posaçme në fushën e mbrojtjes së mjedisit i rolit dhe dallimi ndërmjet kompetencave të secilit prej organeve administrative të ngarkuara me detyra kontrolli, inspektimi dhe ndëshkimi të kundërvajtjeve administrative në fushën e mjedisit duke evituar mbivendosjen e kompetencave dhe duke shmangur mundësitë e mosidentifikimit të shkeljeve dhe personave përgjegjës si rezultat i paqartësisë në rolin dhe detyrat e secilit organ.

Rekomandime administrative

- a) Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve kombëtare duke i njohur me praktikat më të mira në fushën e mbrojtjes së mjedisit jo vetëm në çështjet civile dhe administrative por edhe ato me natyrë penale.
- b) Përfshirja e kurrikulave në Shkollat e Magjistraturës lidhur me krimin mjedisor me qëllim trajtimin fillestar dhe vazhdues të magjistratëve për sa i takon veprave penale në fushën e mjedisit, jurisprudencës së GjEDNJ dhe GjED në çështje të kësaj natyre, si dhe për mekanizmat e zbatimit të Konventës së Aarhusit. Në hartimin e këtyre kurrikulave të merret eksperiencë nga vendet anëtare të BE si: Franca, Italia, Portugalia, Rumania të cilat kanë eksperiencë në adresimin e çështjeve të lidhura me krimin mjedisor. Zhvillimi i trajnimeve me strukturat policore dhe përfshirja e kurrikulave mbi krimet mjedisore në programin e Akademisë së Sigurisë.
- c) Publikimi dhe promovimi i rezultateve të punës së prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm (përveç raporteve vjetore të Prokurorisë së përgjithshme) dhe gjykatave në procedimin e krimeve kundër mjedisit, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve por edhe të publikut të gjerë mbi gamën e krimeve mjedisore. Në këtë aspekt, mund të zhvillohet një sistem gjurmimi i të dhënave dhe rasteve për krimet mjedisore duke rritur transparencën.
- d) Kryerja e inspektimeve tematikeve nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pranë zyrave të prokurorive dhe gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm në lidhje me zbatimin e parashikimeve ligjore gjatë hetimit dhe gjykimit të veprave penale në fushën e mjedisit.

- e) Forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve administrative me Gjyqësorin dhe Prokurorinë. Nevojitet rregullimi dhe forcimi i rolit të Grupit Ndërinstitucional kundër Krimit Mjedisor duke e njohur si të tillë nëpërmjet një akti ligjor dhe duke përcaktuar kompetenca, detyra dhe përbërje në nivel drejtuesish dhe nivel operacional me qëllim sigurimin e funksionalitetit të plotë të tij si një mekanizëm në garantimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për krimin mjedisor dhe bashkëpunimin midis institucioneve.
- f) Rritja e efektivitetit të inspektimit dhe rritja e kapaciteteve profesionale të strukturave inspektuese. Në këtë këndvështrim mund të vlerësohet mundësia e unifikimit të strukturave inspektuese në fushën e mjedisit brenda një institucioni të profilizuar dhe me kapacitete teknike të mjaftueshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe luftës kundër krimit mjedisor. Në çdo rast është e rëndësishme që secili nga inspektoratet të ketë staf, që jo vetëm gëzon statusin e oficerit të policisë gjyqësore por dhe të kryejë trajnime të rregullta mbi përmbushjen e funksioneve dhe detyrave që do të delegohen nga prokurori.
- g) Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe shoqërisë civile e grupeve të interesit. Praktika e zbatuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në lidhje me organizimin e takimeve informuese dhe sensibilizuese me shoqata që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, për referimin në prokurori të rasteve të konstatimit të veprave penale apo për ndërgjegjesimin e shtetasve në lidhje me dëmin që sjell kjo kategori veprash për shoqërinë në tërësi është një praktikë që duhet të ndiqet jo vetëm nga zyrat e tjera prokurorive, por dhe nga organet e tjera ligjzbatuese.
- h) Mediat duhet të kryejnë raportim sistematik për problemet mjedisore duke ndikuar në edukimin dhe ndërgjegjesimin e publikut për dëmin që shkaktojnë krimet mjedisore, për të nxitur reagimin e tyre në vendimmarrje publike që kanë impakt mjedisor dhe për të rritur sensibilizimin në raportimin e rasteve që mund të përbëjnë krim mjedisor.
- i) identifikimi dhe publikimi i vendimarrjeve dhe veprimtarive ku tërheqja dhe pjesëmarrja e publikut është e detyrueshme sipas Konventës dhe legjislacionit vendas, në veçanti nga organet e vetëqeverisjes vendore.

REKOMANDIME NDËRKOMBËTARE

- Legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e mjedisit duhet të përafrohet me atë të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ketë një qasje homogjene të të gjitha vendeve europiane ndaj krimit mjedisor, pasi duhet trajtuar si një sfidë që kapërcen kufijtë.
- Bashkëpunimi mes institucioneve që merren me mbrojtjen e mjedisit përmes shkëmbimit të informacionit, por edhe krijimit reciprok të lehtësive në raste konkrete, sic janë dëshmuar pengesa, në disa raste të referuara në kuadër të këtij projekti (COPEIJ), pikërisht për shkak të legjislacionit të ndryshëm mjedisor e jo vetëm.
- Një kurrikul e unifikuar për krimet kundër mjedisit për shkollat e magjistraturës dhe trajnime të vazhdueshme për këtë temë.

- Një fushatë e targetuar komunikimi mediatic e në rrjetet sociale, e udhëhequr nga Komisioni European dhe e zbatuar nga secili vend për rritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, mbështetjes së institucioneve ligjzbatuese, por edhe denoncimeve qytetare për krime kundër mjedisit.
- Fushata me organizatat e shoqërisë civile dhe shkollat, jo vetëm informimi por edhe inkurajimi e mbështetje të praktikave konkrete për mbrojtjen e mjedisit.

Shtojca

Veprat penale në fushën e mjedisit të parashikuara nga Kodi Penal Shqiptar

Vepra penale kundër mjedisit	Masa ndëshkimore në varësi të rrezikshmërisë
Neni 201- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës	Dënohet me burgim deri në 15 vite
Neni 201/a - Menaxhimi i mbetjeve	Dënohet me burgim deri në 15 vite
Neni 201/b - Transportimi i mbetjeve	Dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vite
Neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme	Dënohet me burgim deri në 15 vite
Neni 201/ç - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme	Dënohet me burgim deri në 20 vite
Neni 202- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Dënohet me gjobë ose me burgim deri në 7 vite

Neni 202/a - Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Dënohet me gjobë ose burgim deri në 3 vite
Neni 202/b - Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore	Dënohet me gjobë ose burgim deri 5 vite
Neni 203-Substancat ozonholluese	Dënohet me burgim nga 1 deri në 7 vite
Neni 204- Peshkimi i ndaluar	Dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vite
Neni 205- Prerja e paligjshme e pyjeve	Dënohet me gjobë ose burgim deri në 1 vit
Neni 206- Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë	Dënohet me burg deri në 3 muaj
Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor	Dënohet me burgim deri në 20 vite
Neni 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Dënohet me burgim nga 2 deri në 8 vite
Neni 207- Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	Dënohet me gjobë

LISTE DES PERSONNES CONTACTEES

Nom prenom	Fonction	Institution	Date
Argjend Qesja	Kancelar i Gjykatës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë	24.03.2023
Blenda Behri	Kancelar i Gjykatës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	27.03.2023
Armela Adivija	Kancelar i Gjykatës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	28.03.2023
Malvin Kokaj	Specialiste e zyrës së statistikave	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	28.03.2023
Viola Kondo	Kancelar i Gjykatës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	28.03.2023
Tefta Mata	Kancelar i Gjykatës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	29.03.2023
Elsi Çausi	Koordinator për të drejtën e informimit	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër	30.03.2023
Adriana Krasniqi	Kancelar i Gjykatës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezha	30.03.2023
Guri Sofi	Kancelar i Gjykatës	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	31.03.2023
Kosta Beluri	Prokuror	Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm	20.10.2023
Elton Qendro	Oficer programi	Zyra për qeverisjen vendore dhe mjedisin. Prezenca e OSBE në Shqipëri	13.10.2023

Konsultimi i faqeve zyrtare në internet i institucioneve :

Gjykata e Lartë : <http://gjykataelarte.gov.al/>

Gjykata Kushtetuese : www.gjk.gov.al

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës: www.pp.gov.al

Gjykata Administrative e Apelit : <https://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-e-apelit/gjykata-administrative-e-apelit/>

Gjykatat e Rretheve dhe Gjykata e Apekit e Juridiksionit të Përgjithshëm

: www.gjykata.gov.al

Ministria e Drejtësisë : <https://www.drejtesia.gov.al/statistika/>

Avokati i Popullit : <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/>

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit: <https://turizmi.gov.al/>

Agjensia Kombëtare e Mjedisit: www.akm.gov.al

Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit: www.ikmt.gov.al

Ministria e brendshme <https://mb.gov.al/>

Identifikimi i OJF-ve të specializuara

Shoqatat e specializuara që kanë ndërmarrë iniciative konkrete në funksion të mbrojtjes së mjedisit:

1. EcoAlbania <https://ecoalbania.org/>
2. Shoqata e Bujqësisë Organike
3. “Shoqata Toka” (Shoqata për ruajtjen dhe mbrojtjen e Alpeve Shqiptare)
<https://mjedisi.al/tag/shoqata-toka/>
4. Gjelbërimi 2000
5. Shoqata Well Point / <https://wellpointalbania.ëordpress.com/>
6. Qendra ALERT <https://alert.al/>
7. Instituti i Politikave Mjedisore <https://iep-al.org/?lang=sq>